



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVO**



**KOMUNA E LIPJANIT**  
**OPŠTINA LIPLJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

<b>Datë:</b>	06.10.2022
<b>Referencë:</b>	
<b>Për:</b>	<b>z.Imri Ahmeti</b> – Kryetar i Komunës së Lipjanit
<b>Kopje:</b>	<b>z.Diamant Bytyqi</b> – Nënkyetar i Komunës <b>z.Lulzim Qerimi</b> – Nënkyetar i Komunës
<b>Nga:</b>	<b>Anila Reçica Llugiqi</b> - Drejtoreshë e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport
<b>Lënda:</b>	<b>RAPORT Mujor SHTATOR - 2022</b>

## **PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT**

Gjatë muajit shtator, në drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale. Greva e hapur në administratën e vendit ka reflektuar edhe në punën e rregullt të DKRS-së, duke mos pranuar studentët në sallat e leximit dhe kërkesat arkivore janë refuzuar më përjashtim të kërkesave urgjente me afate të caktuara të cilat janë përfunduar në procedura të rregullta.

Në raportimet javore e kemi paraqitur punën e drejtoratit.

## **PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE**

- Kemi bërë raportin për muajin gusht 2022,
- Kemi bërë kërkesat për zotim të mjeteve dhe fillimin e procedurave të prokurimit për projektet kapitale dhe kërkesat dhe nevojat tjera të DKRS-së,
- Kemi pritur në takim ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z.Hajrulla Çeku bashkë me kryetarin e komunës z.Imri Ahmeti,
- Puna në qendrën sportive në Lipjan dhe qendrën rinore në Magure ka vazhduar pavarësisht grevës së punëtorëve,
- Aktivitetet sportive të klubeve janë kthyer nga fillimi i muajit shtator,
- Është mbajtur një takim i grupit të OJQ Vorae në qendrën rinore në Magure,
- Kemi përcjellë kërkesë ministrisë së kulturës për planifikimin buxhetor të vitit 2023-2025 të parashihen edhe projektet kapitale që janë në interes shoqërorë, si shtëpia e kulturës, poligonet sportive etj,
- Është kërkuar ndihmë nga ministria e kulturës edhe në hartimin e projektit delat të shtëpisë së kulturës për qytetin e Lipjanit,
- Kemi nderuar me kurora lulesh heroin Arsim Zeqiri në ditën e rënjes,
- Kemi hapur thirrjen publike për mbështetje të projektit për organizimin e festivalit të fëmijëve,
- Kemi filluar takimet me përfaqësues së lokaliteve të komunës së Lipjanit për emërtimin e rrugëve të reja,
- Shërbimet në bibliotekën e qytetit janë ofruar vetëm në marrjen dhe kthimin e librave,
- Shërbimet në arkivën e qytetit janë kryer vetëm ato me afate të caktuara dhe me urgjencë,
- Departamenti i sportit, rinisë dhe kulturës kanë kryer punët për të ecur procesi pa pengesa, pavarësisht grevës.

## STATISTIKAT

Në vazhdim paraqesim raportin në formën tabelare:

### 1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1, -- Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Proces	Të Pazgjidhura
15	2	0	13	-

Tabela- 2, -- Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Në proces	Vërejtje : Te hyrat:
4	1	3	-	28.50€

Tabela- 3, -- Raport për Bibliotekën e Qytetit në Lipjan

Vendi	Libra në huazim	Libra të kthyer	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexues në sallën e leximit	Libra të dhuruara
Spektori për fëmijë	-	-	-	-	-	-
Spektori për të rritur	-	-	-	-	-	-

Tabela- 4, -- Raport për Bibliotekën në Gadime

Libra në huazim	Libra të kthyer	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexues në sallën e leximit
-	-	-	-	-

**Tabela- 5, -- Raport për Bibliotekën në Shalë**

<b>Libra në huazim</b>	<b>Libra të kthyer</b>	<b>Lexues të rinj</b>	<b>Përpunim i librit</b>	<b>Lexues në sallën e leximit</b>
-	-	-	-	-

*Statistikat e bibliotekës së qytetit dhe të terrenit janë të këtij lloji për muajin shtator, për të vetmën arsye të grevës në administratën publike.*

### **DISKUTIME PUBLIKE**

Gjatë muajit shtator nuk kemi pasur asnjë diskutim publik, me përjashtim të diskutimit publik për fillimin e procesit të emërtimeve të reja të rrugëve dhe riemrëtimin e rrugëve.

### **TAKIME TJERA**

Gjatë muajit shtator janë realizuar takime fizike me pale duke trajtuar me kujdesë të veçantë kërkesat e tyre dhe mundësitë e bashkëpunimit.

### **SFIDAT**

Nuk vlerësojmë që kemi hasur në ndonjë sfidë që pengon realizimin e obligimeve të drejtoratit tonë!